

Shkresë informuese sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Shkresë informuese rreth Privatësisë)

I nderuar Klient, ju bëjmë me dije se për qëllime që lidhen me ofrimin e Shërbimit, Easy Market S.p.A., me seli në Rimini, SS Consolare, 51/C, 47900 Rimini, trajton të dhënat e lëshuara nga ju, apo të marra, gjatë ekzekutimit të Shërbimit. Titullari i trajtimit të të dhënave është Easy Market S.p.A. në personin e përfaqësuesit ligjor të përkohshëm. Listimi i personave Përgjegjës për trajtimin e të dhënave personale si dhe marrësve të tretë të komunikimeve është e disponueshme pranë zyrave të Easy-Market S.p.A. Trajtimi i të dhënave bëhet me procedura të posaçme për ruajtjen e sekretit të Përdoruesit dhe konsiston në mbledhjen e tyre, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, përpunimin, ndryshimin, seleksionimin, nxjerrjen, ballafaqimin, ndërlidhjen, bllokimin, komunikimin, shpërndarjen, fshirjen, shkatërrimin e tyre përfshirë kombinimin e dy apo më tepër nga aktivitetet e sipërpërmendura.

Trajtimi i të dhënave, përveç qëllimeve të ndërlidhura, bazike dhe të nevojshme për ofrimin e Shërbimit, ka si qëllim edhe:

- a) Transferimin e të dhënave drejt shoqërive të lidhura, të kontrolluara dhe/apo që kryejnë funksione të lidhura ngushtë dhe janë mjete për operativitetin e Shërbimit edhe përtej territorit të Bashkimit Evropian;
- b) Mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve në rrugë të përgjithshme e të përveçme lidhur me orientimet dhe preferencat e Përdoruesit; dërgimin e informacioneve dhe ofertave tregtare edhe të tretëve; dërgimin e materialit reklamues dhe informues; kryerjen e komunikimeve tregtare, edhe interaktive; kryerjen e aktiviteteve për shitjen apo renditjen e produkteve apo shërbimeve; përpunimin e studimeve apo kërkimeve statistikore rreth shitjeve, klientëve apo informacione të tjera, si dhe t’ua komunikojë ato palëve të treta; t’u kalojë të tretëve të dhënat e mbledhura dhe përpunuara për qëllime tregtare edhe për shitjen apo tentimin për shitje edhe jashtë territorit të Bashkimit Evropian, pra për gjithë ato përdorime me qëllim tregtar dhe/apo statistikor të lejuara nga ligji;
- c) Komunikimin e të dhënave tek Kompanitë që kryejnë funksione ngushtësisht të lidhura me operativitetin e Shërbimit dhe/apo menaxhojnë banka të dhënash që kanë si qëllim ruajtjen e risqeve të kreditit dhe janë të aksesueshme edhe për Kompanitë e treta.

Dhënia e lejes për trajtimin e të dhënave personale nga ana e Përdoruesit është e detyrueshme. Në rast refuzimi të trajtimit të të dhënave personale siç parashikohet në gërmat a) b) dhe c), Kompania nuk do të ofrojë Shërbimin. Trajtimi i të dhënave të Përdoruesit për qëllimet e sipërpërmendura do të bëhet me mënyrat e automatizuara dhe informatike, gjithmonë në respekt të rregullave të ruajtjes së sekretit dhe sigurisë të parashikuara me ligj. Të dhënat do të ruhen sipas ligjit pranë Easy Market sh.a. dhe do të trajtohen nga vartësit dhe/apo profesionistët e ngarkuar nga kjo e fundit, të cilët kryejnë aktivitetet e mësipërme nën mbikqyerjen dhe përgjegjësinë e saj të drejtpërdrejtë. Për këtë qëllim, të dhënat e komunikuara nga Përdoruesi, mund t'u përcillen subjekteve të huaja edhe jashtë shtetit, të cilët kryejnë funksione ngushtësisht të lidhura me operativitetin e Shërbimit. Ju bëjmë gjithashtu me dije se, sipas nenit 12 dhe 13 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, Përdoruesi, sipas mënyrave dhe kufizimeve të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, mund të kërkojë konfirmimin e ekzistencës së të dhënave personale që i përkasin, të marrë njoftime të kuptueshme, të marrë informacion rreth logjikës dhe qëllimeve të trajtimit të këtyre të dhënave, të kërkojë përditësimin, korrigjimin, plotësimin, të kërkojë anulimin, transformimin në formë anonime, bllokimin e të dhënave të trajtuara në shkelje të ligjit, përfshirë këtu ato që nuk janë më të nevojshme për arritjen e qëllimeve për të cilat janë mbledhur, si dhe, në përgjithësi, të ushtrojë të drejtat që i njihen nga dispozitat ligjore në fuqi.